



VENDIM

Nr.25 Datë 10.03.2011

PËR

**LIÇENSIMIN E SHOQËRISË “HEC DRAGOSHTUNJE” SH.P.K NË
AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2 gërma “a”, neneve 9 dhe 13 pika 1, gërma “a”, të Ligjit nr.9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma “a”, nenit 5, pika 1, gërma “a”, dhe neneve 13 e 14 të “Rregullores për Procedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.108, datë 09.09.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 10.03.2011, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “HEC DRAGOSHTUNJE” sh.p.k, si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi liçensimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, të kësaj shoqërie,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “HEC DRAGOSHTUNJE” sh.p.k plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshem dhe rinovimit të licensave si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.



Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Të liçensojë shoqërinë “HEC DRAGOSHTUNJE” sh.p.k, në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec-et “Zanore” me fuqi 1.2 MW, “Dragoshtunje” me fuqi 3.1 MW, “Sheja” me fuqi 1.6 MW dhe “Ura” me fuqi 0.8 MW, për një perudhë 30 vjeçare.
2. Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të Komisionereve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Bujar NEPRAVISHTA



Votimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s për,

VENDIM

Nr. 25 Datë 10.03.2011

PËR

**LIÇENSIMIN E SHOQËRISË “HEC DRAGOSHTUNJE” SH.P.K NË
AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Anëtarët e Bordit

	Pro	Kundër
Bujar Nepravishta	_____	_____
Entela Shehaj	_____	_____
Ardian Haçi	_____	_____
Abaz Aliko	_____	_____
Shkëlqim Bozgo	_____	_____